



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN
E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2020**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent;

Duke njohur përpjekjet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil drejt krijimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Komisionerit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë për detyrë realizimin e reformës në administratën publike, si një nga prioritetet më të rëndësishme që duhen përmbushur për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për vitin 2020 në drejtim të:

Përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga Kuvendi në rezolutën e datës 4.6.2020 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”.

Mbikëqyrjes së 9 institucioneve të varësisë të administratës shtetërore ku janë verifikuar 842 pozicione pune.

Vijimit të procesit për konsolidimin e databazës dhe zgjidhjes së problemeve që dalin gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues.

Realizimit të mbikëqyrjes së rekrutimeve pranë DAP-it, duke monitoruar procedurat e konkurrimit për rekrutimin në grup, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë në administratën shtetërore për 880 pozicione pune.

Përfshirjes në një proces të mbikëqyrjes së orientuar të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, bashki dhe këshilla qarku, me qëllim mbledhjen e të dhënave për të njohur situatën e administrimit të shërbimit civil.

Realizimit të mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e procesit të lirimit nga shërbimi civil të punonjësve që kanë plotësuar moshën për të dalë në pension të plotë pleqërie.

Vijimit të procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit pas përfundimit të afatit të paralajmërimit si për subjektet e mbikëqyrura, ashtu edhe për inspektimet individuale të lidhura me trajtimin e ankesave të nëpunësve civilë.

Kuvendi kërkon që Komisioneri për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të hartojë një analizë të detajuar të shkaqeve për vendet e paplotësuara në pozicionet e shërbimit civil në institucionet e pavarura, administratën publike dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore.

2. Të bëhen përpjekje për vijimin e asistencës dhe këshillimit të njësive përgjegjëse të administrimit të shërbimit civil në nivel vendor për zbatimin e ligjit gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të strukturave finale, hartimit dhe miratimit të përshkrimit të punës.

3. Të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme ndaj institucioneve përgjegjëse të administratës publike në lidhje me proceset e rekrutimit, ngritjes në detyrë dhe shkarkimit, me qëllim sigurimin e zbatimit korrekt të standardeve ligjore.

4. Të vlerësohet impakti i punësimit të studentëve të ekselencës duke referuar numrin konkret të këtyre studentëve që janë aktualisht pjesë e shërbimit civil.

5. Të hartojë një raport vlerësimi për impaktet e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që nga miratimi i tij, duke evidentuar arritjet dhe aspekte të ligjit të cilat duhen përmirësuar nëpërmjet ndryshimeve.

6. Në bashkëpunim me institucionet që punësojnë nëpunës civilë, të hartojë një raport të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore për vitin 2021 dhe t’i vihet në dispozicion Kuvendit të Shqipërisë.

7. Të përditësojë dhe pasurojë me informacion rubrikat në faqen zyrtare të KMSHC-së për të siguruar transparencë dhe për të informuar në vazhdimësi përfituesit e informacionit.

8. Të angazhohet në zbatimin në terma konkretë të marrëveshjes midis KMSHC-së dhe KLSH-së në të gjitha pikat e saj, duke koordinuar gjetjet nga auditimi dhe inspektimi, me qëllim mbulimin me kontroll të administratës publike në nivel qendror dhe vendor.

Miratuar në datën 3.6.2021